



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIAVAU DEJËS

**SHPALLJE PËR VEND PUNE**  
**(shtyerje afati për dorëzim dokumentash)**

**Për zbatimin e Programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara**  
**“Askush të mos mbetet pas” Faza 2/LNB2F”**

Bazuar në Ligjin nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe Marrvëveshjes Standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Vau Dejës mbi Zbatimin e Programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” Faza 2/LNB2F datë 23.06.2023 të lidhur ndërmjet UNDP dhe Bashkisë Vau Dejes, Bashkia e Vau Dejes shpall procedurat e konkurimit për vendin e lirë:

**Psikolog**

**I-Pozicioni i Psikologut**

**a-Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore**

- ✓ Vlerëson aspektet konjitive, emocionale, sociale, ndërpersonale, nivelin e pavarësisë, aftësive të vetë ndihmës dhe funksionimin në komunitet të individit.
- ✓ Diagnostikon, ekzaminon çrregullimet dhe vonesat zhvillimore në bashkëpunim me profesionistët e tjerë.
- ✓ Kryen vlerësime të ecurisë/progresit të fëmijës.
- ✓ Kryen vlerësime të familjes për të identifikuar nivelin e përshtatjes, përballimit dhe stresit tek familja, stilin e komunikimit të prindërve/personit kujdestar dhe cilësinë emarrëdhënies, stilet e përballimit të situatës nga prindi, përgjigjes emocionale dhepërballimit të vëllezërve dhe motrave, nivelit të mbështetjes së prindit, shëndetin mendor dhe fusha të tjera të ngjashme.
- ✓ Bën vlerësim të sjelljes funksionale të fëmijës. Në bazë të këtij vlerësimi harton ndërhyrjet për sjelljet sfiduese.
- ✓ Harton planin e zhvillimit personal dhe planin e zhvillimit të familjes në bashkëpunim me ekipin dhe profesionistët e tjerë.
- ✓ Kryen konsulta/këshillime me vetë fëmijët, stafin, familjen, si dhe personat e entitetet e interesuara.
- ✓ Realizon ndërhyrje dhe punë të drejtpërdrejta terapeutike duke përdorur strategji të ndryshme trajtimi për rritjen e vetë vlerësimit, vetë kontrollit, pavarësisë personale si dhe mirëqenien psikologjike të fëmijës.
- ✓ Mbështet dhe nxit sjelljen pozitive të fëmijës përmes programeve/strategjive të mbështetjes së sjelljes.
- ✓ Mbështet familjen e fëmijës duke punuar direkt me familjen dhe persona të tjerë të rëndësishëm në jetën e fëmijës duke i ndihmuar të kuptojnë nevojat emocionale dhe sociale të fëmijës, të njohin nivelin zhvillimor të tij, reduktimin e izolimit të familjes, mundësi për të mbështetur vëllezërit dhe motrat, fuqizim të familjes për të kërkuar të drejtat e veta, si dhe krijimin e lidhjeve me persona të interesuar (vullnetarët).
- ✓ Mbështet realizimin e aktiviteteve psiko sociale në dobi të gjithëpërfshirjes së fëmijës me aftësi të



- ✓ Çdo fillim muaji Psikologu do të paraqese kalendarin e shërbimit paraprakisht për dijeni Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijeve pranë Bashkisë Vau Dejës .
- ✓ Psikologu do hartojë dhe raportojë në mënyrë progresive ecurinë e punës dhe përmbushjen e objektivave pranë Sektorit të Shërbimit Social.
- ✓ Psikologu do të bashkërendojë punën duke realizuar informim dhe keshillim mes prindit, mesuesit mbeshtetës bazuar ne nevojat specifike të fëmijës.
- ✓ Psikologu do të marrin pjesë në aktivitetet e realizuara nga Sektori Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijeve me qëllim informimin e komuniteteve të varfëra dhe institucioneve si shkolla dhe qendra shëndetësore për rëndësinë e ofrimit të shërbimeve të integruara për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- ✓ Informimi i prindërve të fëmijës përfitues për rëndësinë e trajtimit shëndetësor dhe psikologjik bazuar në nevojat specifike të fëmijës.
- ✓ Krijimi i skedave të personalizuar për secilin fëmijë si dhe detajimi i përshkrimit të punës edhe të prindërve me fëmijët në përditshmërinë e tyre.
- ✓ Takime dhe informim i mesuesve mbeshtetës të fëmijeve që ndjekin shkollat për planin e ndërhyrjes në mënyrë që të bëhet një mirëkoordinim i punës mes profesionistit prinderit dhe mësuesit mbështetës të fëmijës.

### **b-Kualifikimet dhe Cilësitë**

- ✓ Diplomë në degën e psikologjisë.
- ✓ Të jetë i licencuar nga Urdhri i Psikologut ose të regjistruar pranë urdherit të psikologut (Praktikant)
- ✓ Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale
- ✓ Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit
- ✓ Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish në mënyrë profesionale dhe etike
- ✓ Ka respekt për të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes
- ✓ Ka pasion për punën dhe ndihmën ndaj njeriut
- ✓ Njohuri të mira për të drejtat e fëmijës dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës.
- ✓ Tranime kualifikime në fushën e psikologjisë apo punës me fëmijë /persona me aftësi të kufizuara.
- ✓ Gjuha angleze (e preferuar)

### **c-Paga**

- ✓ Pagado të jetë 1000 lekë /Ore

### **d-Vendi dhe koha e punës.**

- ✓ Psikologu do të punojë në zonën e Njësia Administrative Vau Dejës dhe Hajmel. Në përputhje me Kontraten e Punës së shërbimit, personi i kontraktuar Psikologu do të ofrojë 560 senaca të shpërndara në 28 Fëmijë me Aftësi të Kufizuara.

### **e-Dokumentacioni**

- Një letër interesi
- Një CV

*Dokumentacioni d të dorëzohet personalisht nga kandidatët pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Vau Dejës.*

### **f-Procedura e përzgjedhjes dhe shpalljet së kandidatit fitues**

- Kandidatët të cilët kanë shprehur interes për këtë pozicion pune do të përzgjidhen nga Komisioni i Posaçëm i ngritur për këtë procedurë konkurrimi.
- Shpallja e fituesit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Vau Dejës

### **g-Afati i dorëzimit të dokumentacionit**

- Afati për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë deri në datën 01.08.2023, ora 15:00.